



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

2024:119397
Datë: 24.09.2024
Numri i dokumentit: 06198494

K.Dh.Shk.II.nr.735/24

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit N.T.P. Fruti Sh.P.K., me seli në fshatin Reçan, në Prizren, kundër debitorit Lux Sh.P.K., me seli në Lipjan, rr. “Hajredin Bajrami”, me autorizim e përfaqëson Nebih Troshupa, avokat nga Lipjani, sipas dokumentit të besueshëm përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesat e debitorit dhe kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.296/23 të datës 15.09.2023, me datën 23. 09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e kreditorit N.T.P. Fruti Sh.P.K., me seli në fshatin Reçan, në Prizren dhe ankesa e debitorit Lux Sh.P.K., me seli në Lipjan, rr. “Hajredin Bajrami”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.296/23 të datës 15.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.296/23 të datës 15.09.2023, në pikën I të dispozitiv, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Lux Sh.P.K., me seli në Lipjan, rr. “Hajredin Bajrami”, anulohet pjesërisht urdhërin të përmbartuesit privat Rushit Hoxha P.nr.56/23 të datës 26.01.2023, për pjesën e detyrimi prej 4,529.54 euro, së bashku me kamatën për këtë pjesë. Në pikën II e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Lux Sh.P.K., me seli në Lipjan, rr. “Hajredin Bajrami” dhe mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbartimor P.nr.56/23 i datës 26.01.2023 të përmbartuesit privat Rushit Hoxha, sa i përket shumën prej 3,885.76 euro, dhe në pikën III ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbartimore të kreditorit N.T.P. Fruti Sh.P.K., me seli në fshatin Reçan, në Prizren, ndaj debitorit Lux Sh.P.K., me seli në Lipjan, rr. “Hajredin Bajrami”, sipas urdhëri përmbartimore P.nr.56/23 i datës 26.01.2023, për shumën prej 4,529.54 euro së bashku me kamatën ligjore për këtë pjesë.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbare dhe kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, si dhe për shpenzimet e procedurës me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit, të anulohet Aktvendimi KPPP.nr.296/23 të datës 15.09.2023 dhe të shfuqizohet propozimi për përmbare. Po ashtu edhe kreditori ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbare dhe kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit dhe aktvendimi KPPP.nr.296/23 të datës 15.09.2023 të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim apo rivendosje.

Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit dhe e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 26.01.2023, ka paraqitur propozim për përmbare ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – Fatura Nr.22/2183 PR të datës 25.06.2022, Faturës Nr.22/2532 të datës 15.07.2022, Faturës Nr.22/3033 PR të datës 11.08.2022, Faturës Nr.22/3034 PR të datës 11.08.2022 dhe Faturës Nr.22/4314 PR të datës 01.11.2022, të paguaj për shumën e borxhit prej 8,415.30€, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 01.11.2022 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurës përmbare. Përmbaresit privat Rushit Hoxha, me seli në Prizreni, duke vepruar sipas propozimit për përmbare të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm– Fatura Nr.22/2183 PR të datës 25.06.2022, Faturës Nr.22/2532 të datës 15.07.2022, Faturës Nr.22/3033 PP të datës 11.08.2022, Faturës Nr.22/3034 PR të datës 11.08.2022 dhe Faturës Nr.22/4314 PR të datës 01.11.2022, e cilat paraqet dokument përmbarese në bazë të nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbaremit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar se dokumenti i besueshëm në bazë të së cilës është lejuar përmbaremi nuk i plotëson kushtet për tu konsideruar dokument i besueshëm dhe kan arritur marrëveshje gojore për mbylljen e borxhit, andaj i ka propozuar që ta pranoj prapësimin e debitorit dhe të anuloj urdhërin përmbare dhe të obligoj kreditorin që ti bartë shpenzimet e procedurës përmbare.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar me asnjë prove dhe dokumenti përmbanë të gjitha elementet e një dokumenti të besueshëm, gjithashtu vet fakti që nuk e konteston debitori borxhin, andaj ka propozuar që të mbetet në fuqi urdhëri përmbare.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.296/23 të datës 15.09.2023, në pikën I të dispozitiv, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Lux Sh.P.K., me seli në Lipjan, rr. “Hajredin Bajrami”, anulohet pjesërisht urdhërin të përmbauesit privat Rushit Hoxha P.nr.56/23 të datës 26.01.2023, për pjesën e detyrimi prej 4,529.54 euro, së bashku me kamatën për këtë pjesë. Në pikën II e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Lux Sh.P.K., me seli në Lipjan, rr. “Hajredin Bajrami” dhe mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbauesit P.nr.56/23 i datës 26.01.2023 të përmbauesit privat Rushit Hoxha, sa i përket shumën prej 3,885.76 euro, dhe në pikën III ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbauesit të kreditorit N.T.P. Fruti Sh.P.K., me seli në fshatin Reçan, në Prizren, ndaj debitorit Lux Sh.P.K., me seli në Lipjan, rr. “Hajredin Bajrami”, sipas urdhëri përmbauesit P.nr.56/23 i datës 26.01.2023, për shumën prej 4,529.54 euro së bashku me kamatën ligjore për këtë pjesë.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbauesit. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në shkresat e lëndës konstatohet se pretendimet në prapësim janë pjesërisht të qëndrueshëm, sepse i plotëson kushtet ligjore në kuptim të nenit 29 dhe 37 të LPP-së, rrjedhimisht janë përmbushur disa nga kushtet ligjore për anulimin e pjesërishtme të urdhërit të përmbauesit të përcaktuar me nenin 69 dhe 71 të LPP-së.

Po ashtu, kjo gjykatë vlerëson se nga shkresat e lëndës se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur si, në dispozitiv duke llogaritur afatin e arritjes për pagese të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se, Fatura Nr.22/2183 PR të datës 25.06.2022, Faturës Nr.22/2532 të datës 15.07.2022, Faturës Nr.22/3033 PR të datës 11.08.2022, Faturës Nr.22/3034 PR të datës 11.08.2022 dhe Faturës Nr.22/4314 PR të datës 01.11.2022, në vlerë prej 2,035.24 euro, ndërsa borxhi i debitorit rezulton në shumën e përgjithshme prej 3,885.76 euro, ndërsa përmbauesi privat në rastin konkret, ka lëshuar urdhërin dhe e ka detyruar debitorin që të paguaj shumën e përgjithshme prej 8,415.30 euro, pra në këtë rast me propozim për përmbauesit ka kërkuar 8,415.30 euro, ndërsa sipas dokumenteve të lartëcekura shuma arrin prej 3,885.76 euro, prandaj gjykata ka vendosur që të pranoj pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka vendosur si në pik I dhe III të dispozitivit. Ndërsa gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi pjesërisht urdhërin përmbauesit P.nr.56/23 të datës 26.01.2023, pasi që fatura në bazë të së cilës është lejuar ky urdhër, i plotëson kushtet ligjore në kuptim të nenit 29 par. 1 i LPP, i cili përcakton se *“Përmbauesi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, 1.3. faturat, ndërsa me paragrafin 3 të njëjtin nen përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbauesit po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Ndërsa me nenin 37 të LPP-së ku përcakton se : *“Kur propozimi për përmbauesit paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit “*. Gjithashtu gjykata drejt ka vendosur kur, pretendimet ankimore të debitorit se kërkesa e kreditorit është parashkruar në kuptim të nenit

355 par. 1 të LMD-se, dhe gjeti se e njëjtat është e pabaze, ngase në kuptim të kësaj dispozite parashihet se *"Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite"*, ashtu që gjykata konstatoj se nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se propozimi për përmbarrim është paraqitur me datën 26.01.2023, ndërsa faturat e lartcekura janë për periudhën nga data 25.05.2022 e deri me datë 01.11.2022, pra brenda periudhës tri (3) vjeçare. Duke pasur parasysh se është vendosur pjesërisht në aprovimin e prapësimi e debitori, duke u bazuar në nenin 12 para. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 të LPP-së përcakton se: *"Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarrimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera"*.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore dhe debitore, mirëpo të njëjtat i refuzuar si të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës. Së këndejmi, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr.735/24, me datë 23.09.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi